

URDHËR
Nr. 156, datë 15.11.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E DREJTORISË QË DUHET TË PËRMBUSHË ROLIN E
AUTORITETIT MENAXHUES E TË DREJTUESIT TË AUTORITETIT
MENAXHUES, SI DHE DELEGIMI I TË DREJTAVE TË NËNSHKRIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të aneksit B, nënseksioni 3, të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, të nenit 28, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në përputhje me nenin 8, pika 8, dhe nenin 12, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, caktohet për të përmbushur përgjegjësitë e Autoritetit Menaxhues të Programit Operativ Shumëvjeçar për energjinë (2024–2027) në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)” (vendimi IPA III” dhe Marrëveshjen Financiare Kuadër të Partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022 (“Marrëveshja Kuadër”);

2. Z. Ardian Islami, si drejtues i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë është drejtuesi i Autoritetit Menaxhues, në përputhje me nenin 8, pika 8, të vendimit IPA III.

3. Z. Ardian Islami, si drejtues i Autoritetit Menaxhues, është i autorizuar të nënshkruajë dokumentet e mëposhtme:

- Marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Organeve të Ndërmjetme për Menaxhimin e Politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar për zbatimin nën menaxhimin indirekt të programit operativ shumëvjeçar për energjinë (2024–2027) në Republikën e Shqipërisë;

- Marrëveshjet me marrësit fundorë të ndihmës IPA III;

- Manualët e procedurave IPA III të zbatueshme për autoritetin menaxhues;

- Çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me IPA III drejtuar koordinatorit kombëtar të ISPA-s, zyrtarit kombëtar autorizues, autoritetit auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organeve të ndërmjetme për menaxhimin e politikave, Organit të Ndërmjetëm për

Menaxhimin Financiar, AFCOS, Delegacionit Evropian, Shërbimeve të Komisionit Evropian, programeve të tjera që menaxhojnë autoritetet ose organet e ndërmjetme.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku